Kryengritjet shqiptare në Kosovë si alternativë çlirimi nga sundimi serbo-malazez (1913-1914)

Fitim Rifati

Abstrakt: Kryengritjet e armatosura shqiptare kundër pushtimit dhe aneksimit serbo-malazez të Kosovës, paraqesin një tablo realiste të një periudhe historike (shtator 1913 - prill 1914) derisa shqiptarët po përballeshin me tri alternativa për të ardhmen e tyre: organizimin e kryengritjes së armatosur për çlirim, emigrimin dhe asimilimin. Ky artikull studimor paraqet qëndrimin e Mbretërisë së Serbisë dhe Mbretërisë së Malit të Zi ndaj shqiptarëve, kryesisht ndaj atyre myslimanë, shkaqet e organizimit të kryengritjeve të armatosura për çlirim dhe rezultatet e tyre. Përmes burimeve arkivore, shtypit periodik të kohës, dokumenteve të botuara dhe literaturës historiografike, prezantohen informacione dhe interpretime të reja, të cilat ndriçojnë dhe ndërtojnë ngjarje, dukuri dhe personalitete, që e kanë karakterizuar Kosovën gjatë asaj kohe. Gjithnjë e më shumë, duke u mbështetur në të dhënat burimore, është arritur në konstatimin se Mbretëritë Serbo-Malazeze në Kosovë synonin zbatimin e politikave shtetërore, të cilat çonin drejt ndryshimeve kombëtare, demografike, kulturore dhe rrënjësisht në dëm të popullsisë shqiptare.

Fjalët kyçe: Kosovë, shkatërrim, serbizim, kryengritje.

Assist. Prof., Institute of History "Ali Hadri" Prishtina, fitim_rifati@hotmail.com

0000-0003-3413-7681

© Association of Education and Thought Fettah Efendi
DOI: http://doi.org/10.51331/A004
Journal of Balkan Studies, 2021,
balkanjournal.org

Recieved: 24.08.2020
Revision: 08.10.2020
Accepted: 14.11.2020

Abstract: The Albanian armed uprisings against the Serbian and Montenegrin occupation and annexation of Kosovo, present a realistic tableau of a historical period (September 1913 - April 1914) until the Albanians were confronting with three alternatives for their future: organizing the armed uprising for liberation, emigration and assimilation. This study article explicates the attitude of the Kingdom of Serbia and the Kingdom of Montenegro towards Albanians, primarily to those Muslims, the causes of the organization of armed uprisings for liberation and their results. Through archival sources, the press of that time, published documents and historiographical literature, presented new information and interpretations whom enlighten and construct events, occurrences and personalities, which have characterized Kosovo during that time. Increasingly, relying on the source data, reached in ascertainment that the Serbo-Montenegrin kingdoms in Kosovo intended to implementation the state policies whom lead towards national, demographic, cultural and radical changes to the detriment of the Albanian population.

Keywords: Kosovo, destruction, Serbianisation, uprising.

Qëndrimi serbo-malazez ndaj shqiptarëve në Kosovë dhe pozita e gruas

Pushtimi serbo malazez i Kosovës në tetor-nëntor të vitit 1912, solli një situatë të re për popullsinë shqiptare. Mbretëria e Serbisë dhe Mbretëria e Malit të Zi, ndonëse kishin proklamuar se shqiptarëve në Kosovë do t'u garantoheshin të drejtat dhe prona e tyre, nuk zbatuan vendimet e Konferencës së Ambasadorëve për të respektuar të drejtat e minoriteteve. Përkundrazi, në lëmshin politik të krijuar gjatë dhe pas Luftërave Ballkanike, ato mbajtën një qëndrim të kundërt ndaj jetës dhe pronës së shqiptarëve. Veç çarmatosjes, shteti serb bëri përpjekje për të tërhequr bashkëpunëtorë të veçantë nga radhët e shqiptarëve, për t'i vënë në shërbim të interesave të tij. (Војновић, 631 :1984) Në të vërtetë, prijësit shqiptarë të Kosovës me orientim kombëtar, por edhe popullsia civile, nuk pranuan të bashkëpunonin me organet serbe. Për këtë arsye, pa zbatuar procedura gjyqësore, ata u burgosën, u izoluan, u internuan dhe u vranë. Në mesin e tyre ishin edhe krerët e Drenicës, si: Halil Haxhia, Hetem Kozhica, Fejzullah Lubaveci, Temë Dobrosheci, Rexhep Llausha dhe tetëmbëdhjetë krerë të tjerë, të cilët i ekzekutuan në Kaçanik. (AIHT, 11 shtator 1 :1913; Liri e Shqipërisë, 2 :1913) Sipas politikës propaganduese dhe shoviniste të qeverive serbo-malazeze, shqiptarët e Kosovës nuk përbënin kurrfarë elementi me rëndësi kulturore, historike e kombëtare. (Лукач, 264 :1981) Ata konsideroheshin "të egër" (Војновић, 371 :1984), "gjakpirës" (Cana, 201 :1997), "mashtrues", "dinakë", "të pabesë", "konservatorë", "regresivë" (Политика, 1 :1914), "kusarë" etj. (Shala, 150 :1990) Administrata ushtarake, policore dhe shtetërore, madje edhe elementi serb në Kosovë, i kishin duart të lira të vepronin ndaj shqiptarëve, për t'i torturuar dhe rrahur ata deri në vdekje. (AIHT, 10 janar 2 :1914) Rrjedhimisht, ky qëndrim solli tensionimin e raporteve ndëretnike dhe nxitjen e konflikteve ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë.

Këto regjime zbatuan një politikë hegjemonie e shkatërrimi ndaj shqiptarëve, dogjën fshatrat, masakruan banorët, plaçkitën pasurinë dhe grabitën pronat e tyre. (АВИ, 2 фебруар 1 :1913; Çeku & Destani, 52-49 :2015; Freundlich, 39-7 :2010) Në platformën e tyre për Kosovën dhe shqiptarët, e cila bazën kryesore e kishte te "Projekti" ("Naçertania") shovinist i Ilia Garashaninit dhe projekte të tjera, zbatohej me përpikëri parimi bosht politik:

> "Serbizim me çdo çmim". (AIHT, 29 shtator 1913: 2; Germek, Gjidara & Šimac, 2010: 29-104; Verli, 1998: 21-29; Bajrami, 2004: 9-64)

Inspektori i Policisë serbe në Shkup, Mihailo Ceroviç, i kërcënonte e shantazhonte shqiptarët, duke u vërsulur ndaj tyre se:

> "do t'u shkurtonjë këmbët e kryet po të mos bëhen sërbë". (Perlindja e Shqipëniës, 1913:2)

Në këtë kontekst, synimi i politikës serbo-malazeze në Kosovë ishte shtypja politike dhe ekonomike e shqiptarëve, për t'i dëbuar ata nga atdheu i tyre, Kosova, dhe për të vendosur kolonë serbë, me qëllim realizimin e kësaj platforme. Në një pozitë shumë të rëndë ishin familjet e prijësve politikë të Kosovës, si: Hasan Prishtina, Isa Boletini e Bajram Curri, për faktin se gjatë kohës që ata vepronin në Shqipëri, familjet e tyre përpos vëzhgimit të vazhdueshëm nga organet ushtarake dhe policore, njëherazi, nuk u lejuan të lëviznin nga shtëpitë e tyre dhe aq më pak të niseshin drejt Shqipërisë. (Perlindja e Shqipëniës , 1913: 2; Duka, 2012: 124) Serbo-malazezët, veç presionit ndaj këtyre familjeve, synonin tërheqjen e këtyre prijësve në Kosovë, për t'i neutralizuar përpjekjet që ata bënin për çlirimin e Kosovës.

Regjimi ushtarak serbo-malazez u përpoq t'i armiqësonte shqiptarët, duke nxitur përçarje mbi baza fetare ndërmjet tyre. Shqiptarët katolikë në Kosovë u përballën me pretendimet për t'i rreshtuar në kuadër të kornizave dhe interesave të politikës serbe e malazeze dhe për t'i futur në konflikt me shqiptarët myslimanë. (AIHT, 18 mars 1914: 1) Masë tjetër e marrë nga pushteti serb e malazez ndaj shqiptarëve ishte edhe shërbimi i detyrueshëm ushtarak. Shqiptarët obligoheshin t'u përgjigjeshin ftesave, të cilat përcilleshin me kërcënime për të kryer shërbimin ushtarak. (Shqypnia e Re, 1913: 3) Në rast se refuzonin ose nuk i përgjigjeshin me kohë thirrjes për të përfunduar këtë shërbim, pasonin sanksione të rënda me masat: keqtrajtim dhe burgosje. (AIHT, 23 janar 1914: 3) Këto masa të ashpra patën për pasojë një shpërngulje të konsiderueshme jashtë Kosovës të personave të aftë e njëkohësisht edhe të familjeve të tyre, të cilat dëshironin t'i shmangeshin paraprakisht detyrimit ushtarak dhe dënimeve nga mosrespektimi i tij. (AIHT, 6 janar 1914: 1) Këto masa ishin në kundërshtim me vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër dhe ato të Marrëveshjes Osmano-Serbe, të nënshkruar në Stamboll, më 14 mars të vitit 1914. Kjo marrëveshje i siguronte të drejta qytetare dhe politike popullsisë myslimane nën Mbretërinë e Serbisë, i garantonte nënshtetë-

sinë osmane për tre vite pas nënshkrimit të saj, nuk e detyronte atë të paguante asnjë lloj takse, nuk e detyronte t'i nënshtrohej pushtetit ushtarak, i garantonte të drejtën e paprekshmërisë së pronës, i premtonte vetëqeverisje lokale, respektim të besimit, zakoneve, shkollimit etj. Kjo marrëveshje ishte një lloj presioni ndaj Mbretërisë së Serbisë për të ruajtur popullsinë myslimane në Kosovë, por nuk u jetësua në praktikë dhe në perspektivë rrezikonte shqiptarët nga shkombëtarizimi dhe emigrimi. (ASHAK, 1912-1913: 2; Политика, 1914: 2) Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje nuk ndodhi për shkak se Mbretëria e Serbisë, si para, ashtu edhe pas nënshkrimit të saj, zbatoi një politikë serbizimi në Kosovë. (Malcolm, 2011: 336) Lidhur me mosrespektimin e kësaj marrëveshjeje, ambasadori britanik në Beograd, Dayrell Crackanthorpe, më 26 maj 1914, i dërgoi një raport konfidencial Sekretarit të Jashtëm, Edward Grey, në të cilin, midis të tjerash, nënvizoi:

> "...Zyrat administrative në territoret e reja (Kosovë dhe vise të tjera, F. R.) u mbushën kryesisht me një grup zyrtarësh të papërvojë dhe të paskrupuj, që abuzuan me autoritetin e tyre në çdo drejtim, nuk lanë gur pa lëvizur për të mbushur xhepat e tyre dhe ndoqën një politikë shtypjeje të hapur ndaj pakicave të huaja... Pakicat në territoret e aneksuara do të vazhdojnë të vuajnë përsa i përket lirive të tyre civile dhe fetare". (Çeku & Destani, 2015: 149-150)

Gjithashtu, edhe gruaja në Kosovë, e cila para pushtimit serbo-malazez, ndonëse jetonte në një shoqëri konservatore dhe në pabarazi gjinore, kishte të drejta të caktuara që i garantonte sistemi juridik osman dhe e drejta zakonore. (Musaj, 1998: 59) Mirëpo, gjendja e gruas nën pushtimin e ri u përkeqësua jashtëzakonisht. Përkundër jetesës në një shoqëri patriarkale me tradita të vjetra (Begolli, 1984: 17-30), qenia e saj ishte vënë në rrezik, sepse ajo përballej me probleme të shkaktuara nga rrethanat e reja politike. Në shënjestër të keqtrajtimeve fizike e psikologjike ishte posaçërisht gruaja shqiptare. Ajo u ballafaqua me një situatë të ekspozuar me rreziqe të vazhdueshme (tortura, vrasje, çnderime, martesa e konvertime të dhunshme) dhe shpeshherë e pambrojtur nga aksionet dhe operacionet ushtarake, policore e shtetërore serbo-malazeze ndaj shtëpive dhe familjeve shqiptare. Nën pushtimin serbo-malazez, asaj i mohohej çdo e drejtë shoqërore dhe kulturore. E kufizuar në ekonominë familjare, krahas veprimtarisë në punët e shtëpisë, si: përgatitja e ushqimeve dhe kujdesit ndaj fëmijëve, bagëtisë e shpezëve, gruaja punonte edhe tokat bujqësore, si: mbjelljen, korrjen e dëlirjen

e grurit, kositjen e sanës dhe grumbullimin e saj në arë. (Berisha, 2004: 66-71; Populli, 1915: 4) Mirëpo, i tërë ky rol dhe kontribut i saj i pazëvendësueshëm në familje nëpërkëmbej, shpërdorohej, ndëshkohej e përmbysej si pasojë e brutalitetit të pushtuesve serbo-malazezë.

Gjatë kësaj periudhe në Kosovë, sipas normave juridike, fetare dhe atyre zakonore, gruaja ishte e obliguar të ushtronte veprimtarinë në shtëpi dhe, sa herë që dilte jashtë mureve të shtëpisë, pavarësisht se nuk u praktikua në përgjithësi, sidomos në zona rurale, ishte e detyruar të mbulonte fytyrën me perçe dhe trupin me ferexhe. (Musaj, 1998: 59) Organet e pushtetit serbo-malazez në Kosovë nuk pranonin të respektonin traditën kulturore dhe të veshjes së gruas shqiptare. Në këtë kontekst, në shënjestër të abuzimeve ishin edhe aktet ceremoniale të martesave, kurorëzimeve dhe festave familjare, në të cilat gruaja shqiptare shënonte momente të veçanta të jetës së saj. Gjatë këtyre rasteve ndërhynin nëpunës të organeve administrative, të cilët jo vetëm që ndalonin dhe prishnin ceremonitë festive, por urdhëronin që vajzat dhe gratë shqiptare të hiqnin mbulesën nga koka, duke paragjykuar e cenuar nderin dhe besimin e tyre. (AIHT, 19 mars 1914: 3) Gruaja shqiptare rrezikohej rëndë gjatë aksioneve kontrolluese ushtarake dhe policore ndaj shtëpive dhe familjeve, që dyshoheshin për veprimtari subversive kundër regjimit serbo-malazez. Në mungesë të burrave dhe të pambrojtura e nën presione, gratë kërcënoheshin, fyheshin e grabiteshin me forcë. Raste të tilla u shënuan shpesh në Kosovë. Në janar të vitit 1914, me arsyetimin për të kapur kryengritësit shqiptarë, organet serbe realizuan një operacion kontrolli në shtëpinë e Fazli Kabashit në Apterushë të Rahovecit. Gjatë këtij operacioni, sekretari i komunës së Zaçishtës dhe xhandarët serbë, ofenduan me fjalë të rënda në mënyrë të veçantë gratë e kësaj shtëpie. Mirëpo, pronari i shtëpisë dhe burrat e tjerë reaguan në çast, duke u përleshur me sekretarin dhe xhandarët, ndërsa si pasojë e përleshjes u vra djali i F. Kabashit, disa mysafirë e një pjesë u plagosën. (AIHT, 16 janar 1914: 2) Me këto aksione, jeta normale e gruas shqiptare bëhej e pasigurt dhe e pamundur përballë një makinerie ushtarake dhe shtetërore antishqiptare. Në shënjestër të sulmeve të administratës serbo-malazeze ishin edhe përfaqësueset shpirtërore katolike (murgeshat). Murgeshat e Manastirit katolik në Prizren, çdoherë që dilnin jashtë mureve të tij, provokoheshin dhe sulmoheshin nga ushtarët serbë. Për të kompromet uar misionin që kryenin, pushteti serb vinte në dyshim edhe shërbimin e tyre fetar. (Војновић, 1984: 366)

Gruaja shqiptare, sikurse burrat, u ballafaqua edhe me procesin e konvertimit fetar, i cili u drejtua nga organet shtetërore dhe kisha ortodokse serbo-malazeze. Aksionet e ushtrisë serbe e malazeze, me qëllim plaçkitjen, bastisjen, torturat, konvertimin dhe vrasjen e shqiptarëve, pothuajse ishin bërë përditshmëri. Kështu, në pranverë të vitit 1914, në njërin nga këto operacione, shtatë ushtarë serbë u futën në mbrëmje në shtëpinë e një shqiptari, ku pronarit i kërkuan me forcë t'ua jepte paratë. Të pakënaqur me kaq, duke u larguar i grabitën dy vajzat e tij, të cilat i detyruan të mohonin fenë islame dhe të deklarohen se tani e tutje përqafonin fenë e krishterë, përkatësisht ritin ortodoks. (Taraboshi, 1914: 2) Abuzimet e dhunimet që administrata shtetërore, ushtarake dhe policore serbo-malazeze ushtronte ndaj gruas shqiptare në Kosovë, thelloheshin sidomos në raste krizash e revoltash të armatosura të shqiptarëve. Kështu, pas kryengritjes së armatosur të shqiptarëve në pranverë të vitit 1914, në shenjë hakmarrjeje, ushtria dhe grupet civile të armatosura serbe u sollën në mënyrë çnjerëzore ndaj gruas shqiptare. Për mizoritë serbe në viset e Kosovës raportonte edhe shtypi shqiptar i kohës. Gazeta Taraboshi, e datës 17-18 prill 1914, që botohej në Shkodër, shkruante se:

"...graat janë t'dhunueme e mandej t'mytuna...". (Taraboshi, 1914: 3)

Elementi serb që jetonte në Kosovë, ose i printe ushtrisë serbe në ndërmarrje të tilla ose ishte pjesëmarrës i tyre. Kështu, kishte plot raste kur serbët lokalë i shfrytëzuan rrethanat politike për të kryer akte çnjerëzore ndaj vajzave e grave shqiptare. Në këtë kohë u shtuan rastet kur vajzat shqiptare në fshatrat e Kamenicës grabiteshin me dhunë prej famëkeqit Koica Popoviq nga Maroca, i cili njihej për veprimet çnjerëzore ndaj shqiptarëve të kësaj treve. Ai grabiti dy vajza shqiptare në fshatrat Kranidell dhe Kremenatë. (Latifi & Sermoxhaj, 2002: 28; Redenica, 2014: 48-53) Gjatë kësaj kohe, organet e administratës ushtarake dhe shtetërore serbe, në shumë operacione që ndërmerrnin ndaj familjeve shqiptare, shpeshherë i përfundonin ato në shenjë hakmarrjeje duke çnderuar e përdhunuar gratë dhe vajzat shqiptare. (Besa shqyptare, 1915: 2-3) Në rrethana të tilla të një pushtimi dhe regjimi ushtarak, pozita shoqërore, ekonomike dhe kulturore e shqiptarëve ishte absolutisht shtypëse dhe diskriminuese në çdo aspekt të jetës. Në vargonjtë e projekteve shoviniste serbo-malazeze, shqiptarët synohej të dëboheshin, të shkombëtarizoheshin, të konvertoheshin në fenë ortodokse dhe të sllavizoheshin.

Kryengritja e armatosur si opsion kundër sundimit serbo-malazez në Kosovë (1913)

Shqiptarët, për shkak të divergjencave politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore-arsimore, duke mos parë perspektivën e tyre brenda pushtetit arbitrar e të dhunshëm serbo-malazez, ndodheshin përballë tre opsioneve për të ardhmen e tyre: 1. Organizimi i një kryengritjeje, si shans i fundit për t'u çliruar nga dhuna sistematike ose përfundimisht për t'u flijuar në trojet e tyre; 2. Emigrimi si mundësi për të shpëtuar nga gjendja e rëndë me shpresën për një jetë më të sigurt; 3. Asimilimi ose sllavizimi, që nënkuptonte pranimin e pushtimit dhe administrimit serbo-malazez me të gjitha dimensionet e tij politike, ekonomike, shoqërore e kulturore-arsimore.

Që në fillimet e veta, shqiptarët në Kosovë nuk e pranuan pushtimin serb e malazez (Dreshaj, 1991: 256) dhe nuk u pajtuan me vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër, për aneksimin e viseve të tyre Mbretërisë së Serbisë e Malit të Zi. (AIHT, 26 shtator 1913: 1) Në fillim të muajit shtator të vitit 1913, organet shtetërore serbe shpallën zyrtarisht aneksimin e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare. (Verli, 2004: 163) Krerët shqiptarë, sapo u njoftuan me këtë vendim, përmes një memorandumi të dërguar nga Kosova, menjëherë kërkuan nga ministrat e Punëve të Jashtme të gjashtë Fuqive të Mëdha jo vetëm të rishikonin vendimet e Londrës, por të përmirësonin padrejtësitë kombëtare ndaj shqiptarëve. Ata ankoheshin për dhunën dhe mizoritë që po përjetonin si pasojë e këtij regjimi. (Liri e Shqipërisë, 1913: 2) Sipas politikanit socialdemokrat serb, Kosta Novakoviç, deri në fund të vitit 1913, ky regjim shfarosi më shumë se 120.000 shqiptarë të të gjitha moshave, si dhe shpërnguli me dhunë më tepër se 50.000 vetë në drejtim të Perandorisë Osmane dhe Shqipërisë. (Novakoviç, 1990: 305) Ndonëse shifrat mbi numrin e shqiptarëve të vrarë dhe të dëbuar vazhdojnë të jenë të papërcaktuara, sipas Raportit të Komisionit Ndërkombëtar të Hetimeve, të përgatitur nga Fondacioni Karnegi për Paqen Ndërkombëtare (1914), konstatohet:

> "Shtëpi dhe fshatra të tëra ishin bërë hi e pluhur, shumë njerëz të pafajshëm e të paarmatosur ishin masakruar, akte të pabesueshme dhune, plaçkitje dhe brutalitet i çdo lloji - të tilla ishin mjetet që u përdorën dhe ende po përdoren nga ushtria serbo-malazeze, me qëllim të ndryshimit rrënjësor të strukturës etnike të rajoneve të banuara ekskluzivisht nga shqiptarët". (Carnegie, 1914: 151)

Udhëheqësit e lëvizjes kombëtare nga Kosova, të cilët vepronin në shtetin shqiptar, nisën të ndërmerrnin masa organizimi për të shprehur pakënaqësitë e tyre përmes veprimeve të armatosura, ndërsa brenda territoreve të aneksuara, shqiptarët kryenin sulme e aksione klandestine, pikësynim i të cilëve ishin përfaqësuesit ushtarakë, policorë e shtetërorë serbo-malazezë. (Cana, 1997: 300-307) Vetëm vrasja e një xhandari në Fshaj të Gjakovës, më 7 shtator 1913, e nxiti pushtetin serb që në shenjë hakmarrjeje të urdhëronte djegien e fshatit dhe të 32 banorëve në Ujz, masakrimin e popullsisë së fshatit Fshaj, si dhe djegien e fshatit Smaç. (AIHT, shtator 1913: 2) Në anën tjetër, vjelja arbitrare e taksave të prapambetura të periudhës osmane, madje edhe e atyre zyrtarisht të falura, si dhe taksat e reja të ngarkuara, sipas zëvendëskonsullit britanik në Shkup, Walter Divie Peckham:

"shqiptarëve u kishin ardhur në majë të hundës". (Duka, 2012: 123)

Në këtë situatë të tensionuar e të padurueshme, organet më të larta ushtarake të Mbretërisë së Serbisë, duke qenë në dijeni për lëvizjet e shqiptarëve rreth Gjakovës e Prizrenit, urdhëruan komandat ushtarake të qarqeve dhe rretheve të Pazarit të Ri, Mitrovicës, Prizrenit, Prishtinës dhe Gjakovës, të vinin në funksion divizionet e tyre me qëllim të ruajtjes së kufirit, sigurisë dhe parandalimit të një kryengritjeje të mundshme të shqiptarëve të Kosovës. (ASHAK, 5 shtator 1913: 2)

Shqiptarët nga Kosova të përqendruar në Shqipëri nën drejtimin e Isa Boletinit, Bajram Currit, Riza Gjakovës, Mehmet Derrallës, Bajram Daklanit etj., po përgatiteshin për një sulm të armatosur kundër pushtetit serbo-malazez. Qëllimi i tyre ishte çlirimi i Kosovës e viseve të tjera të pushtuara e të aneksuara dhe bashkimi i tyre me Shqipërinë. Për të realizuar këtë qëllim, ata ishin bashkuar në shoqërinë "Shkipnia". (Џамбазовски, 1983: 252; Duka, 2012: 242) Në gjysmën e dytë të shtatorit të vitit 1913 nisën sulmet e shqiptarëve ndaj forcave ushtarake serbe në zonën kufitare me krahinën e Lumës. (Џамбазовски, 1983: 262) Sipas informacioneve që kishte siguruar Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë së Serbisë, pretendohet se gjoja "invazioni shqiptar në territorin serb" (Marcovitch, 1921: 15) ishte përgatitur dhe orkestruar nga Qeveria e përkohshme e Vlorës prej një periudhe tremujore, nën dirigjimin e ministrit Hasan Prishtina e Isa Boletinit dhe nën agjitimin e vazhdueshëm të Bajram Currit e Riza Gjakovës, të cilët përgjatë kësaj periudhe, edhe nën influencën austro-hungareze, kishin siguruar armë e municion të nevojshëm. Duke përdorur si pretekst kërkesën e tyre për të vizi-

tuar tregjet e Dibrës dhe të Gjakovës, shqiptarët kishin arritur të çanin kontrollin kufitar të ushtrisë, duke e orientuar sulmin e tyre në tre drejtime: në drejtim të Dibrës, të Ohrit dhe të Prizrenit. Për veprimet e shqiptarëve, qeveria serbe me shqetësim i kishte njoftuar edhe Fuqitë e Mëdha. Për të kundërvepruar ndaj kryengritjes së organizuar, ajo urdhëroi shtimin e forcave ushtarake në zonat e luftimeve. (Јукач, 1981: 377-378) Në fakt, Qeveria e përkohshme e Vlorës, në krye me Ismail Qemalin, ishte e detyruar të mbante një qëndrim të përmbajtur dhe të mos përfshihej me anë të mekanizmave zyrtarë në radhët e kësaj kryengritjeje, sepse i druhej kompromet imit nga Fuqitë e Mëdha. (Historia e Popullit Shqiptar, 2007: 431) Për shtypjen e kësaj kryengritjeje, Mbretëria e Serbisë kishte aktivizuar 20.000 - 50.000 ushtarë. (AIHT, 25 shtator 1913: 1; Perlindja e Shqipëniës, 1913: 6) Mirëpo, kjo kryengritje, edhe pse nuk kishte të njëjtin intensitet dhe nuk filloi njëkohësisht në të gjitha trevat (Murzaku, 1996: 125), shumë shpejt u shtri në thellësi të Kosovës deri në afërsi të Prishtinës, në zonën e Drenicës, në rrethinën e Mitrovicës (AIHT, 9 tetor 1913: 3), në Rrafshin e Dukagjinit (Duka, 2012: 117, 216-217) dhe gradualisht përfshiu gjithë territorin e saj. (Liri e Shqipërisë, 1913: 1) Kjo kryengritje përfshiu edhe Shkupin, Tetovën, Gostivarin, Kërçovën, Manastirin dhe rrethinat e tyre. (Xhemaili, 2008: 112; Destani & Elsie, 2018: 252-270) Alarmi dhe paniku që kaploi ushtrinë serbe ndikoi që të jepej urdhri për ngujimin në shtëpitë e tyre të banorëve të Prizrenit dhe rrethinës. Për rrjedhojë, në mungesë të ushqimit pati edhe vdekje të banorëve. (Duka, 2012: 333) Në anën tjetër, pas luftimeve të zhvilluara disa ditë në Junik, Rekë të Keqe, Malësi të Gjakovës, Bec dhe në Dushkajë, ushtria malazeze vrau 87 burra në Ponoshec të Gjakovës në shenjë hakmarrjeje për dy ushtarë të vrarë dhe një të plagosur. (Shqypnia e Re, 1913: 2) Ajo masakroi popullsinë, dogji e shkatërroi fshatrat shqiptare si: Maznik, Jabllanicë, Zhabel, Novosellë, Dushkajë, Strellc, Popoc etj. (AIHT, 27 shtator 1913: 1) Shtypi socialdemokrat serb në atë kohë raporton te nga vendi i ngjarjes për reprezaljet e ushtrisë serbe ndaj shqiptarëve. Një ushtar serb, përmes gazetës Radnicke novine, ndër të tjera konstatonte se kishte:

> "...fshatra me njëqind, njëqind e pesëdhjetë, dyqind shtëpi ku nuk ka më as një burrë... Ne... i shpuam me bajonetat tona". (Cana, 1986: 324; Swire, 2005: 152)

Kryengritja e shqiptarëve revoltoi aq shumë autoritetet ushtarake serbe, saqë tërë arsenalin luftarak e kishin vënë në përdorim kundër shqiptarëve, "për t'i shfarosur të gjithë". (Duka, 2012: 123) Organet ushtarake, për të rritur shkallën e presionit, kër-

cënonin se do të burgosnin gratë e prijësve shqiptarë: Hasan Prishtinës, Isa Boletinit e Bajram Currit, por edhe udhëheqësve të tjerë, në rast se ata nuk dorëzoheshin ose nuk pranonin pushtetin dhe administrimin serbo-malazez me të gjithë komponentët e tij në Kosovë. (Duka, 2012: 123-124) Megjithëse kryengritja e organizuar nuk posedoi forcën e as numrin e konsiderueshëm të luftëtarëve për të sfiduar ushtrinë serbe, ajo njëkohësisht nuk pati as mbështetjen e faktorit ndërkombëtar, i cili shprehej se respektonte vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër. (Лукач, 1981: 408; Rizaj, 2005: 206) Qëndrimi i Fuqive të Mëdha, sidomos i Rusisë dhe i Francës, për pushtetin serb e malazez nënkuptonte legjitimimin e ndëshkimit më të fortë dhe likuidimit fizik të çdo elementi a grupi të shqiptarëve që ndërmerrte veprime kundër tyre.

Sprapsja e shqiptarëve nga ushtria serbe pas një javë luftimesh, i krijoi kushte të përshtatshme Komandës së Lartë, për të përdorur masa represive ndaj shqiptarëve. (Atdheu, 1913: 3) Ushtria dhe grupet civile serbe vrisnin me ndjenja krenarie dhe pa kurrfarë procedure paraprake popullsinë shqiptare në Kosovë. Një ndër komitët serbë nga Çagllavica, afër Prishtinës, deklaronte dhe e pranonte me mburrje se në ngjarjet e fundit "kishte vrarë 100 shqiptarë". (AIHT, 24 tetor 1913: 2) Në bazë të një raporti, nga një pjesëtar i një grupi komit serb, dërguar kryetarit të Parlamentit të Mbretërisë së Serbisë, Andre Nikoliq, më 30 nëntor 1913, në mes të tjerash, theksohej:

> "Kudo ku ka kaluar ushtria jonë duhet dërguar tjetër popull, meqenëse ai popull dhe çdo gjë që i përkiste atij është zhdukur tërësisht". (Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX, 2017: 452)

Rrjedhimisht, kjo kryengritje i shërbeu Mbretërisë së Serbisë si pretekst për ripushtimin e një pjese territoriale të shtetit shqiptar, me qëllim për të zgjeruar "kufirin strategjik", duke filluar nga bjeshka e Bogës dhe Valbona në veri deri në kufirin grek në jug mbi liqenin e Ohrit. Kësisoj, në këtë zonë okupimi hynte pjesa më e madhe e Malësisë së Gjakovës, Hasi, Luma, Lura, Dibra, Çermenika, Malësia e Qukësit, Derveni, Mokra, Pogradeci dhe Starova. Ndërkaq, Mbretëria e Malit të Zi ripushtoi pjesën tjetër të Malësisë së Gjakovës deri te Fierza dhe Merturi. (Cana, 1998: 15, Rizaj, 2011: 435-446) Në këtë kontekst, Mbretëria e Serbisë, përmes rihapjes së problemit të "pikave strategjike", dëshironte të ndryshonte kufirin shqiptaro-serb, të vendosur në Konferencën e Ambasadorëve në Londër.

Mirëpo, pavarësisht reprezaljeve, zona kufitare ndërmjet Prizrenit dhe Gjakovës ka-

rakterizohej nga grupe shqiptarësh, të cilët në çdo moment ishin të gatshëm të organizonin sulme ndaj forcave ushtarake serbe e malazeze ose të demonstronin lidhur me kërkesat e tyre drejtuar Komisionit të Caktimit të Kufirit Verior të Shqipërisë, për të shtyrë vijën kufitare sa më thellë në viset perëndimore të Kosovës. (Duka, 2012: 254-257) Ndërkohë, në fund të vitit 1913 dhe në fillim të vitit 1914, në zonën malazeze nisën bastisjet e keqtrajtimet ndaj familjeve të patriotëve shqiptarë, që kishin marrë pjesë në kryengritjen e vitit 1913. Një pjesë e këtyre familjeve dëbohej nga shtëpitë e tyre jashtë kufijve të administrimit malazez. (Bicaj, 2003: 202) Duke vlerësuar peshën e lëvizjeve refraktare të shqiptarëve në orbitën e faktorit ndërkombëtar, më 21 nëntor 1913, Mbreti Nikolla I Petroviq, përmes një proklamate drejtuar shtetasve malazezë në viset e pushtuara, ndër të tjera premtonte kujdesin dhe sigurinë personale dhe pronësore, gjykata efektive e nivel modern të arsimit, si dhe zhvillim të hovshëm ekonomik. Po ashtu, ai shprehej se Mbretëria e tij do të respektonte lirinë e mendimit dhe të besimit për myslimanët dhe katolikët, të cilët ishin nën mbrojtjen shtetërore të Malit të Zi. (Глас Црногорца, 1913: 1-2) Mirëpo, në ditët vijuese u dëshmua se proklamata e Mbretit malazez ishte një premtim i rremë.

Kryengritja e vitit 1914 dhe reprezaljet serbo-malazeze kundrejt shqiptarëve

Edhe pas Kryengritjes së shtatorit të vitit 1913, shqiptarët nuk mund të qëndronin të ndarë dhe nën presionin e një dhune konstante e diktature ushtarake të vendosur nga organet e pushtetit serb e malazez në Kosovë, prandaj, si brenda, ashtu edhe jashtë saj, po planifikonin që në pranverë të vitit 1914 të organizonin një revoltë të re. (AIHT, 17 janar 1914: 1) Në këtë kontekst, zbarkimi i Princ Vidit në Shqipëri, më 7 mars 1914, për stabilizimin dhe konsolidimin politik e shtetëror të saj (Milo, 2013: 190), ndikoi në inkurajimin e patriotëve të Kosovës në Durrës, të cilët ishin bashkuar në Shoqërinë "Besa Shqiptare", e formuar në këtë qytet, më 18 mars 1914. (AIHT, 25 prill 1914: 1) Ata shpresonin se Princ Vidi do të mbështeste programin e saj për çlirimin e trevave të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare. (AIHT, 25 prill 1914: 1; Политика, 1914: 1) Mirëpo, ai, duke u përballur me një situatë të rëndë politike në Shqipëri, mbante një qëndrim të kujdesshëm karshi kërkesave të shqiptarëve të Kosovës, për të organizuar një sulm të armatosur kundër Mbretërisë së Serbisë e asaj të Malit të Zi dhe për të çliruar Kosovën. (Shala, 1988: 279) Misioni i Princ Vidit ishte konsolidimi shtetëror i Shqipërisë

dhe ruajtja e asnjanësisë së saj, karshi ngjarjeve në rajon. (Swire, 2005: 191) Ndërkohë, në Mbretërinë e Serbisë dhe atë të Malit të Zi, nisi një fushatë kompromet uese kundër Princ Vidit, me qëllim mjegullimin dhe diskreditimin e menjëhershëm të rolit të tij karshi ambicieve kombëtare të popullsisë shqiptare në Kosovë. (Duka, 2012: 314-315) Pretendimet shtetërore dhe të organeve të shtypit për të dezinformuar shqiptarët, në radhë të parë i shërbenin interesave të politikës serbo-malazeze në Kosovë, të cilën synonin ta mbanin të shtypur, të nënshtruar dhe të kontrolluar në çdo sferë të jetës.

Shqiptarët, të organizuar në grupe të vogla klandestine, të cilat vepronin brenda e jashtë viseve të Kosovës, vazhduan të shfaqnin revoltën e tyre përmes aksioneve të armatosura guerile kundër xhandarmërisë dhe përfaqësuesve të pushtetit administrativ. Në fillim të vitit 1914, të tilla veprime kishin marrë përmasa të gjera, saqë nisën të alarmonin qeverinë në Beograd, se situata e sigurisë në rajonet e Kosovës ishte e brishtë dhe duhej të ndërmerreshin hapa frenues, për të mbajtur shqiptarët nën kontroll. Në këtë kontekst, zona kufitare me Shqipërinë vazhdonte t'u sillte probleme serioze autoriteteve ushtarake serbo-malazeze në Kosovë. (AIHT, 30 prill 1914: 2; Политика, 1914: 2) Në anën tjetër, për të shtuar terrorin e dhunën ndaj shqiptarëve (Политика, 1914: 1), qeveria në Beograd organizonte dhe sillte në vise të Kosovës elementë kriminelë-kolonizatorë, të cilët, në momentin që bashkoheshin me grupet e çetave komite serbe, të drejtuara nga kryetari i komitetit të rekrutimit Bogdan Radenkoviq dhe anëtarët Risto Egnenoviq, Griso Elezoviq dhe gazetari David Dimitrijeviq, shtonin edhe më nivelin e krimeve ndaj shqiptarëve. (AIHT, 19 mars 1914: 4; Durham, 2000: 270)

Organet ushtarake dhe policore kryenin vazhdimisht aksione kontrolli nëpër shtëpitë e shqiptarëve me qëllim zbulimin e grupeve kryengritëse, që gjenin strehim në popull dhe familje të caktuara. (AIHT, 16 janar 1914: 1; Taraboshi, 1914: 2) Sipas një raporti të konsullit të përgjithshëm austro-hungarez në Shkup, Heinrich Jehlitschka, më 31 mars 1914, i cili bazohej në informata të besueshme, ndër të tjera, thuhej:

> "...Shqiptarët nxirren natën nga shtëpitë, çohen në fushat, ku gjinden varreza të përgatitura më përpara, theren atje me thika në qetësi të plotë dhe futen në gropë. Grave, që kërkojnë të vrarët u thuhet vetëm se burrat ose djemtë e tyre janë dërguar në Beograd". (AIHT, 31 mars 1914: 2)

Këto veprime shkatërruese serbo-malazeze ndaj shqiptarëve, përmes një raporti, i konstatonte edhe Komisioni Hetimor Ndërkombëtar i vitit 1914. (E vërteta mbi Ko-

